

VENDIM
Nr. 614, datë 20.10.2021

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË VENDIMIN NR.1151, DATË 24.12.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E NUMRIT TË PUNONJËSVE ME KONTRATË TË PËRKOHSHME PËR VITIN 2021 NË NJËSITË E QEVERISJES QENDRORE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 18, të ligjit nr.7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 12, të ligjit nr.137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr.1151, datë 24.12.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në pikën 1, numri i punonjësve me kontratë të përkohshme ndryshohet dhe bëhet 2605 veta.

2. Në lidhjen nr.1, përmendur në pikën 1, të vendimit, bëhet shtesa e mëposhtme:

a) Në ndarjen “Gr.13, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale”, shtohet nënndarja përkatëse, sipas tabelës nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Fjalja e fundit, e pikës 6, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Përfshirje bëjnë specialistët e aparatit të Kryeministrit, të cilët paguhën në kategorinë e pagës së nivelit III-b dhe specialistët e Shërbimit Social Shtetëror, të cilët paguhën me IV-a”.

II. Ngarkohet Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të depozitojë pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë detajimin e numrit të punonjësve me kontratë, periudhën kohore të punësimit dhe kategorinë përkatëse të pagës së tyre.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Tabela nr.1

Gr.	Emri i Institucionit	Nr. Punonjësve	Emërtesa	Koha mesatare ditore	Periudhë kohore
13	Ministria Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale				
	Drejtorja e Përgjithshme e SH.S.SH	15	Specialiste	8 orë/ ditë	tetor-dhjetor
	Drejtorja e Përgjithshme e SH.S.SH	1	Kryekujdestare	8 orë/ ditë	tetor-dhjetor
	Drejtorja e Përgjithshme e SH.S.SH	12	Kujdestare	8 orë/ ditë	tetor-dhjetor
	Drejtorja e Përgjithshme e SH.S.SH	2	Kuzhinierë	8 orë/ ditë	tetor-dhjetor
	Drejtorja e Përgjithshme e SH.S.SH	3	Sanitare	8 orë/ ditë	tetor-dhjetor
	TOTAL PUNONJËS ME KONTRATË	33			